



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

**SHPALLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**“Specialist i burimeve njerëzore” në Drejtorinë e Burimeve
Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit
Kategoria e pagës IV-1**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, ndryshuar me të fundit nr. 746, datë 19.12.2018, Autoriteti i Konkurrencës shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin në kategorinë ekzekutive:

- “Specialist i burimeve njerëzore” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit.
- Kategoria e pagës IV-1

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve

23 janar 2026

****Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipërm është:

1. Specialisti përgjigjet për zbatimin e rregullave dhe dispozitave ligjore në menaxhimin e burimeve njerëzore. Merret me krijimin, administrimin, sisteminin, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave të dokumentacionit të personelit të çdo nëpunësi të institucionit. Përpilon listëprezencat për efekt pagese. Plotëson të dhënat në dosjet individuale të punonjësve dhe librezën e punës, regjistrin themeltar të punësimit, etj.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria IV-1);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e drejtësisë;
- b) Të zotërojnë aftësi të punës në grup;
- c) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë;
- d) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit në nivel ekzekutiv;
- e) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- f) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

- b) fotokopje të diplomës;
- c) fotokopje të librezës;
- d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e) Vërtetimi të gjendjes gjyqësore;
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

Numër kontakti dhe adresë vendbanimi.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës **23 janar 2026**.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **26 janar 2026**, njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;
- b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- c) Konkurrimi do të bazohet dhe në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Politika Kombëtare e Konkurrencës, Kodin e Procedurave Administrative.
- d) Për më shumë: www.caa.gov.al

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti i Konkurrencës do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AK. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Pranim në shërbimin civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e drejtësisë;
- b) Të zotërojnë aftësi të punës në grup;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

- c) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë;
- d) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 vit;
- e) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- f) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës dhe listës së notave;

c) fotokopje të librezës së punës;

d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g) Numër kontakti dhe adresë vendbanimi.

*Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e cituara më sipër me postë ose dorazi, brenda datës **23 janar 2026** në Autoritetin e Konkurrencës me adresë: Rruga "Sami Frashëri", kati IV. Nr.4.*

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Konkurrencës për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Konkurrencës duke filluar nga data **26 janar 2026**.

Tiranë, më 08.01.2026